



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.656-2/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelet e subjekteve politike Nasha Iniciativa, me seli në Mitrovicë, Lista Boshnjake Unioni Social Demokrat, me seli në Prizren si dhe Nova Demokratska Stranka me seli në Prizren, të paraqitura kundër vendimit me numër 860-2021 të dt. 04.03.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, lidhur me rezultatin përfundimtar të publikuar me datë 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e Panelit, të mbajtur më datë 10.03.2021, mori këtë:

## AKTVENDIM

**I. KORIGJOHET** vendimi i PZAP-it Anr.656/2021 i datës 07.03.2021, (ashtu që në faqen I-rë, pikën I. të dispozitivit të vendimit në rreshtin e fundit gabimisht është shënuar numri i fletëvotimeve 147 të anuluar të subjektit politik Social Demokratska Stranka Unija- SDU, e që do të duhej të ishte numri 2), ashtu që fshihet numri 147 i fletëvotimeve, ndërsa mbetet numri 2.

**II.** Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar

**III.** Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit A.nr.656/2021 i datës 07.03.2021.

## Arsyetim

PZAP-i, duke vepruar sipas apeleve të subjekteve ankuese me vendimin Anr.656/2021 të datës 07.03.2021, ka pranuar pjesërisht apelet e subjekteve ankuese duke vendosur me decidivisht si në pikat -I-, -II- dhe -III-, të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës sipas detyrës zyrtare me rastin e paraqitjes së përgjigjes në ankesë ka konstatuar se në pikën -I-, të dispozitivit Anr.656/2021 i datës 07.03.2021, (ashtu që në faqen I-rë, pikën I. të dispozitivit të vendimit në rreshtin e fundit gabimisht është shënuar numri i fletëvotimeve 147 të anuluar të subjektit politik Social Demokratska Stranka Unija- SDU, e që do të duhej të ishte numri 2).

Andaj, duke ju referua të cekurave më lart dhe duke u mbështetur në nenin 165 të LPK-së, erdhi në përfundim se duhet bërë korrigjimin e vendimit të lart cekur, për arsye se është vërtetuar se është bërë gabime në numra në të shkruar.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**  
Anr.656-2/2021 datë 10.03.2021

**Kryesues i Panelit**

**Rrustem Thaqi**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 4 i LZP-së,